3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6: Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Materiali me PDF**

Specifikimi i Materialeve: **Materiali me PDF**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Materiali me PDF**

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 9 muaj

N.r	Pershkrimi Punimet	Kohëzgjatja e Punimeve (Muaj)								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Punime përgatitore	■								
2	Punime prishje		■	■						
3	Punime murature			■	■					
4	Punime betoni dhe armature			■	■	■	■			
5	Punime hidroizolimi dhe çatie				■	■	■			
6	Punime rifiniture dhe suvatime						■	■	■	■
7	Punime shtresash dhe tavani			■	■	■				
8	Punime dyer dritare								■	■
9	Punime bojatisje								■	■
10	Punime instalime Hidrosanitare						■	■	■	■
11	Lidhja sistemeve teknike me rrjetin							■	■	■
12	Instalime elektrike							■	■	■

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës sipas DST;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës sipas DST;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës sipas DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 50% vlera e fondit limit që prokurohet**.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për kestet e maturuara për vitin **2026**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi** i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

a) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- f. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

Shenim: Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 A “Punime gërmimi në tokë”;
- NP-2 A “Ndërtime civile dhe industriale”;
- NP-12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS-2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”;
- NS-4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”;
- NS-8 A “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri”;
- NS-14 A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”;
- NS-18 A “Punime topogjeodezike”;

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist 2 (dy)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (nje)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (nje)
- Arkitekt 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- **Inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni / me kontrate bashkëpunimi** 1 (nje)
- **Inxhinier Mekanik / me kontrate bashkëpunimi** 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- **Inxhinier Hidrogeolog / me kontrate bashkëpunimi** 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Materialesh / 1 (nje)
- Inxhinier Per Menaxhim Projektesh / 1 (nje)

Për drejtuesit teknik të paraqitet diploma, kontrata noteriale e punës, si dhe te figurojne listepagesat e shoqerise në datën e hapjes se tenderit .

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për çertifikimin si më sipër kerkohet, emër/mbiemër, numrin dhe daten e çertifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar këtë çertifikim.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

2.4 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet te kene te punesuar staf e punonjesve te kualifikuar ne perputhje me ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë.” si me poshte:

- | | | |
|-----------------------------|---------|-----------------------------|
| - Teknik Ndertimi | 1 (nje) | Diplome shkolle e mesme |
| - Teknik Mekanik | 1 (nje) | Diplome shkolle e mesme |
| - Teknik Gjeometer/Topograf | 1 (nje) | Diplome shkolle e mesme |
| - Elektracist | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Hidraulik | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Hidroizolues | 2 (dy) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Specialist ngrohje-ftohje | 1 (nje) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Karpentier | 5(pese) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Hekurkthyes | 5(pese) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |
| - Betonues | 5(pese) | Çertifikate trajnimi/Deshmi |
| Profesionale/Diplome | | |

- Murator Profesionale/Diplome 3 (tre) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Suvatues Profesionale/Diplome 3 (tre) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Punetor veshje fasade Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Pllakashtrues Profesionale/Diplome 2 (dy) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Montues parketi Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Bojaxhi Profesionale/Diplome 2 (dy) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Punetor duralumini Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Punonjës Gipsi Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Saldator Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Pergatites te trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome konstruksioneve metalike 2 (dy) Çertifikate
- Marangoz/Mobilier Profesionale/Diplome 1 (nje) Çertifikate trajnimi/Deshmi
- Shofer 4 (kater) Leje Drejtimi kategoria C minimalisht
- Manovrator 4 (kater) Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)
- Buldozerist 2 (dy) Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)
- Punetore te thjeshte 25 (njezet e pese)

- Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome/Deftese te Shkolles se Mesme/ Deshmitë profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme, Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe te të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në datën e hapjes së tenderit .

- *(Në rastin kur makineritë disponohen me qera për shoferët dhe manovratorët nuk kërkohet disponimi i tyre në listpagesat e shoqërisë, pasi këto punonjës mund të kontraktohen).*

- **Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:**

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (N rast se leshueshte instituc privat)
1					
2					

--	--	--	--	--	--

-
- *Elektriciteti i kërkuar si me sipër, duhet të jetë i kualifikuar/certifikuar për instalimin e paneleve diellore, nga institucione publike/private të licencuara sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë.
- *Lidhur me saldatorët e kërkuar si me sipër, duhet të jenë të kualifikuar/certifikuar sipas standardit SSH EN ISO 9606-1, sa i përket kërkesave për testimin dhe kualifikimin e saldatorëve për saldimin e celiqeve, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-
- *Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për kualifikimet/certifikimet si më sipër kërkohej, emër/mbiemër, numrin dhe datën e certifikatës, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar kualifikimet/certifikatat përkatëse.*

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e proceseve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, (**AK pranon si mundësi që punonjësi i sipërcituar mund të disponohet edhe me kontratë bashkëpunimi**) të pajisur me certifikatë/dëshmi kualifikimi të lëshuar nga subjekte të licencuara/akredituara sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht për datën e hapjes së tenderit , punonjës me specialitetin si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si **Ekspert Zjarrfikës**, për dhenien asistencës teknike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e proceseve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, (**AK pranon si mundësi që punonjësi i sipërcituar mund të disponohet edhe me kontratë bashkëpunimi**) **Një punonjës”Certifikatë për Auditues Energjetik në Ndërtesa”, lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë.** (AK pranon si mundësi që inxhinieri i sipërcituar mund të disponohet edhe me kontratë shërbimi)

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emër/mbiemër, titullin e kualifikimit/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikatës, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organizatës kualifikues/certifikues kompetent.*

2.4.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e proceseve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me çertifikatë/dëshmi kualifikimi të lëshuar nga subjekte të licencuar/akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht për datën e hapjes së tenderit, punonjës me specialitetin si më poshtë:

1 (një) punëtor veshje fasade dhe 2 (dy) përgatitës të konstruksioneve metalike, të trajnuar për punime në lartësi të cilët të jenë të pajisur me çertifikatë “Për punimet në lartësi”, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emër/mbiemër, titullin e kualifikimit/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikatës, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit kualifikues/certifikues kompetent.*

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë duhet të disponojë fuqi punëtore jo më pak se **100** (njëqind) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht për datën e hapjes së tenderit. Vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për datën e hapjes së tenderit.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për datën e hapjes së tenderit

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ **ekuivalent**. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përditësuar, ose (SSH EN **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose **ekuivalent** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe

sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Certifikatën SSH EN **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH EN **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim e vlefshme **ose ekuivalent**). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese per produktet/materialet/pajisjet si me poshte:

- 1- Profile per dritare dhe dyer d/alumini: Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar.
- 2- Celik per konstruksione metalike: Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar.
- 3- Hekur betoni periodik. Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar.
- 4- Boje hidroplastike (ekologjike): Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar.
- 5- NVR smart32 channel dhe POE deri ne 16ch IP hyrje kamerash;
- 6- Rack mural 230V,16A;
- 7- Switch i menaxhueshem Smart me 24 Porta per POE, 1 porte per RJ45 dhe 2 porte per fiber optike;
- 8- Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx,;
- 9- Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP66;
- 10- Panel kontrolli konvencional me 2 zona: Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar
- 11- Transformator fuqie 630 KVA,Cele Transformatori 24Kv, Cele linje 24kV
- 12- Tuba te brinjezuar HDPE dhe rakorderi PPR: Autorizim

Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar

2.5.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence te leshuar nga QKL “Per grumbullim, ruajtje dhe transportim te mbetjeve inerte **Kodi III.2.B**, ku te paraqitet se bashku me aktin e miratimit per kodet perkatese 12 01 13 Mbetje nga saldimet
17 01 01 Beton 17 08 02 Materiale ndertimi gips
17 01 02 Tulla 20 02 02 Dhera dhe gure
17 02 01 Dru 20 01 28 Bojera ngjyra ngjites etj
19 10 01 Hekur dhe mbetje celiku

➤* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

2.5.2 *Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator*

testimi ku laboratori të ketë të akredituara këto teste SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1744- 1:2009+A1:2012, SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M.

2.5.3 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	5
Autovinc mbi 30 ton (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Eskavator me zinxhir minimalisht 40 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Miniskavator me goma 5-8 ton (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Mineskavator me zinxhir gome	Ne pronesi ose qira	Cope	1

Grejder (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Sonde shpimi mikrotunelesh me drejtim me lazer	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Autobetoniere kantieri 3-5m3(MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Autopompe betoni	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Minifadrome (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Fadrome (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Buldozier	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kompaktor	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Depozite uji 5000 litra	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Rul gome-hekur mbi 20 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Rrul me dhembe	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Dumper kantieri 5-10 ton (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Skeleri	Ne pronesi ose qira	m2	1000
Armatura per kallepe	Ne pronesi ose qira	m2	75
Pirun teleskopik (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kamioncine 3.5-5 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Saldatriçe	Ne pronesi ose qira	Cope	3
Autobot Uji	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Matrapik	Ne pronesi ose qira	Cope	3
Trapan magnetik per hapjen e vrimave ne metal	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Total station	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Dron i pajisur me lidar	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Autofshese me goma (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Helikopter per shtresa	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Pajisje Wellpoint per largimin e ujerave nentokesore me sistem gjilperthithese	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX	Ne pronesi ose qira	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikaten e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; për secilin mjet.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerave/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot

dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/
Kontrate bashkepuniimi, krahas dokumentacionit te mesiperm,
duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepuniimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Specifikimet teknike, HVAC, Elektrike ,mekanike,specifikat kabina elektrike të ngarkuara në SPE ,por Ak do të lërë mundësinë edhe të paraqitjes edhe të SSH/CEI/EN/ISO .

Te specifikimet Teknike do te hiqen të gjitha referimet që janë me markë/ prodhuesi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikimit. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁵ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

